

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 527 Prot.

Tiranë, më 24.05 2016

VENDIM Nr. 31, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "SCODRA"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof.As. Dr. Saimir Shpuza (IA) Prof. Piotr Dyczek (Universiteti i Varshavës, Poloni),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "SCODRA"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. As. Dr. Saimir Shpuza (IA) Prof. Piotr Dyczek (Universiteti i Varshavës, Poloni) në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Kërkime në qytetin e poshtëm ku do të rimerren gërmimet arkeologjike në ndërtimin romak të shekullit të II të identifikuar nga sondazhet e 2011
 - Gjithashtu, në qytetin e sipërm parashikohet të gërmohet në një shkallë të gjerë duke rimarrë gërmimet e vitit 2014 pranë Kishës së Shën Stefanit
 - Këtë vit projekti shqiptaro-polak do të fillojë edhe ndërtimin e hartës GIS për territorin e Shkodrës ku do të fokusohet më shumë në sitet e fortifikuara.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë 7 maj - 8 qershor 2016.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO